



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 845/5 prot.

Tiranë, më 10.11.2025

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr.50, datë 10.11.2025

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, NË
LIDHJE ME VEPRIMET ADMINISTRATIVE TË KRYERA GJATË PROCESIT
TË ECURISË DISIPLINORE, NË INSTITUCIONIN E QENDRËS KOMBËTARE
TË BIZNESIT DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË
RREGULLUAR PALIGJSHMËRINË E KONSTATUAR**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore ndaj nëpunëses Florina Hajredinaj, në institucionin e Qendrës Kombëtare të Biznesit,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është regjistruar informacioni me shkresën nr. 845 prot., datë 8.10.2025, të dërguar nga nëpunësja Florina Hajredinaj, me detyrë “Përgjegjëse e Sektorit të Regjistrimit të Biznesit”, në Drejtorinë e Regjistrimit të Biznesit dhe Lejeve/Licencave/Autorizimeve, pranë institucionit të Qendrës Kombëtare të Biznesit, është njohur me pretendimet e nëpunëses, për parregullsi të lejuara/kryera në

zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, në ngarkim të saj.

Konkretisht, në përmbajtje të informacionit dhe të dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, parashtrohet se, me aktin nr. 16731/11 prot., datë 3.10.2025, “*Vendim*”, të Komisionit të Disiplinës, në ngarkim të nëpunëses Florina Hajredinaj është dhënë masë disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, për shkelje të parashikuara në nenit 57, pika 2, germa a) dhe c) dhe pika 3, germa a), të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Në informacionin e dërguar, nëpunësja pretendon se, gjatë zhvillimit të ecuresë disiplinore në ngarkim të saj, nga ana e Komisionit të Disiplinës dhe Kryetarit të këtij organi, janë kryer shkeljet e evidentuara si më poshtë:

Së pari, sa i takon organit administrativ i cili ka tagrin për nisjen e ecuresë disiplinore, nëpunësja parashtron se, ky proces ka nisur nga titullari i institucionit, në tejkalim të kompetencave të tij, ndërkohë që, eprori i drejtëpërdrejtë i saj Drejtori i Drejtorisë së Regjistrimit të Biznesit dhe Lejeve/Licencave/Autorizimeve, nuk është njoftuar për fillimin e ecuresë disiplinore dhe për asnjë nga aktet e lidhura me këtë proces, si dhe nuk ka qenë pjesë e Komisionit Disiplinor.

Së dyti, sa i takon evidentimit dhe klasifikimit të shkeljeve në ngarkim të nëpunëses, pretendohet se, i gjithë procesi disiplinor mbështetet në gjetjet e Raportit Përfundimtar të hartuar në datën 26.8.2025, nga grupi i hetimit administrativ, të ngritur pranë institucionit të QKB-së, ndërkohë që, sipas nëpunëses në përmbajtje të këtij raporti, nuk është konstatuar asnjë shkelje konkrete apo parregullsi në drejtimin dhe organizimin e detyrave, të Përgjegjësit të Sektorit të Regjistrimit të Biznesit, pozicion në të cilin është e emëruar kjo nëpunëse.

Së treti, sa i takon përbërjes së Komisionit Disiplinor, pretendohet se, ky organ ka në përbërje 4 anëtarë: Kryetar, Sokol Bardhi, me detyrë Drejtori i Përgjithshëm i QKB-së; Doljana Stoja, anëtar përfaqësues i QKB; Viola Treska, anëtar përfaqësues i QKB; Albi Mato, anëtar si përfaqësues i DAP, të cilët janë përcaktuar në kundërshtim me kërkesat e pikës 2, kreu I, të VKM-së nr. 115, datë 5.3.2014 dhe pikës 18.1, të Udhëzimit nr. 1, datë 21.1.2025, të DAP.

Së katërti, sa i takon anëtarit të KD, znj. Doljana Stoja, parashtrohet se, ka qenë pjesë e grupit të punës që ka kryer hetimin administrativ për verifikimin dhe vlerësimin e punës së Drejtorisë së Regjistrimit të Biznesit, në QKB për periudhën janar - korrik 2025. Për pasojë, nuk duhet të ishte anëtare e KD, pasi presumohet se ka interes në rezultatin e këtij procesi dhe ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave, në kuptim të nenit 30, të Kodit të Procedurës Administrative.

Së pesti, në përmbajtje të informacionit pretendohet se, në dhënien e masës disiplinore, Komisioni i Disiplinës, nuk ka respektuar parimet për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore, por kjo masë është dhënë mbështetur në disa shkelje të cilat, referuar rregullores së brendshme të institucionit nuk janë detyrë e Përgjegjësit të Sektorit të Regjistrimit të Biznesit.

Për më tepër, mendimi i pakicës në Komisionin e Disiplinës, i anëtarit përfaqësues të Departamentit të Administratës Publike ka shprehur qartë dhe haptazi shkeljen e ligjit dhe parimeve bazë të legjislacionit për nëpunësin civil nga Komisioni Disiplinor, i QKB-së.

Në këto kushte, nëpunësja ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Komisionit Disiplinor, gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.

Me qëllim verifikimin e rastit, me marrjen e këtij informacioni, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, nëpërmjet shkresës nr. 845/1 prot., datë 13.10.2025, *“Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të administruar me shkresën nr.845 prot., datë 8.10.2025, dërguar nga nëpunësja Florina Hajredinaj, institucioni Qendra Kombëtare e Biznesit”*, ka vënë në dijeni institucionin për fillimin e verifikimit të kësaj procedure disiplinore, si dhe ka kërkuar dokumentacionin në të cilën është materializuar ajo.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën nr. 19018/1 prot., datë 15.10.2025, me objekt: *“Përgjigje shkresës suaj nr. 845/1 prot., datë 13.10.2025”*, e protokolluar pranë Komisionerit me nr. 845/2 prot., datë 16.10.2025, ka dërguar dokumentacionin në të cilin materializohet procedura disiplinore e ndjekur në këtë rast.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar rezulton se, me aktin nr. 2117/21 prot., datë 14.8.2014, të njësisë përgjegjëse DAP, nëpunëses Florina Hajredinaj, e emëruar në pozicionin *“Specialist (regjistrues)”*, në Sektorin e Regjistrimit, në Drejtorinë e Regjistrimit, në Institucionin Qendra Kombëtare e Regjistrimit, i është deklaruar statusi i punësimit si *“nëpunës civil”*.

Më tej, nëpërmjet aktit nr. 1269/14 prot., datë 18.4.2016, të njësisë përgjegjëse DAP, *“Transferim i përhershëm për shkak të ristukturimit”*, është vendosur transferimi i përhershëm i nëpunëses Florina Hajredinaj, në pozicionin *“Specialist (regjistrues)”*, në Sektorin e Regjistrimit të Biznesit, në Drejtorinë e Regjistrimit të Biznesit dhe Lejeve, Licencave, Autorizimeve, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe së fundmi, nëpërmjet aktit nr. 2758 prot., datë 27.4.2021, *“Emërim”*, të njësisë përgjegjëse DAP, është emëruar, në pozicionin *“Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimit të Biznesit”*, në Drejtorinë e Regjistrimit të Biznesit dhe Lejeve/Licencave/Autorizimeve, pranë institucionit të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Në vijim, të marrëdhënies së punësimit në këtë pozicion pune, sipas dokumentacionit të paraqitur nga nëpunësja, rezulton se, me aktin nr. 16731/11 prot., datë 3.10.2025, “Vendim”, të Komisionit të Disiplinës, në ngarkim të nëpunëses Florina Hajredinaj është dhënë masë disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, për shkelje të parashikuara në nenin 57, pika 2, germa a) dhe c), dhe pika 3, germa a), të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Sa i takon ligjshmërisë së dhënies së kësaj mase disiplinore, vlerësojmë se duhet të analizohet baza ligjore që e rregullon këtë institut të ligjit.

Konkretisht, në nenin 57, “*Përgjegjësia për masat disiplinore*”, përcaktohet përgjegjësia e nëpunësit civil për shkeljen me faj të detyrimeve sipas ligjit, si edhe kategorizimi i shkeljeve në:

a) shkelje shumë të rënda; b) shkelje të rënda; c) shkelje të lehta.

Më tej, në pikën 2, të këtij neni, parashikohet kategorizimi i shkeljeve shumë të rënda; në pikën 3, i shkeljeve të rënda dhe në pikën 4, i shkeljeve të lehta.

Ndërsa, në nenin 58, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, parashikohen “*Llojet e masave disiplinore*” të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, në një rast kur evidentohen shkelje disiplinore:

“Masat disiplinore që mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil janë:

a) vërejtje;

b) mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj;

c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet.

ç) largim nga shërbimi civil”,

dhe në nenin 59, të këtij ligji, përcaktohet kompetenca dhe procedura për dhënien e tyre. Sipas pikës 2, të kësaj dispozite, masa e parashikuar në germën a) të nenit 58, jepet nga eprori direkt i nëpunësit, ndërsa masat e parashikuara në gerrat b), c) dhe ç) jepen nga Komisioni Disiplinor, për çdo nëpunës civil në institucion.

Në referim të pikës 10, të nenit 59, të ligjit në fjalë, është parashikuar se, Këshilli i Ministrave miraton me vendim rregullat e hollësishme të procedurës disiplinore, si dhe rregullat për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor. Ky detyrim ka gjetur zbatim me miratimin e Vendimit nr. 115, datë 5.3.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil*”, i ndryshuar.

Konkretisht, në aktin nënligjor që rregullon disiplinën në shërbimin civil, (VKM nr.115/2014), në kreun I “*Organet Disiplinore*”, pika 1, përcaktohet se:

“Organet disiplinore, sipas ligjit, janë: Komiteti Kombëtar i Përzgjedhjes, për anëtarët e TND-së (KKP); komisioni disiplinor (KD), për nëpunësit e tjerë, dhe eprori direkt”.

Më tej, me qëllim zbatimin e unifikuar të rregullave dhe procedurës administrative disiplinore, nga ana e institucioneve të administratës shtetërore, Departamenti i Administratës Publike ka nxjerrë Udhëzimin nr. 1, datë 21.1.2025, *“Për organet disiplinore dhe procedurën e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”*.

Në rastin konkret, pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar dhe bazës ligjore të cituar më lart, sa i takon pretendimeve të ngritura nga nëpunësja Florina Hajredinaj, rezulton se:

Së pari, sa i përket organit administrativ i cili ka tagrin për nisjen e ecuresë disiplinore, në pikën 7, të Udhëzimit nr. 1, datë 21.1.2025, *“Për organet disiplinore dhe Procedurën e Shqyrtimit të Shkeljeve Disiplinore”*, të DAP, parashikohet se, eprori i drejtpërdrejtë, në rastet kur vihet në dijeni të një pretendimi për shkelje disiplinore, e vlerëson paraprakisht atë, bën vlerësimin e shkeljeve disiplinore me faj, të pretenduara përkundrejt nëpunësit civil dhe i klasifikon ato.

Gjithashtu, në këtë akt nënligjor, në pikën 3/2/ç, parashikohet se: epror i drejtëpërdrejtë për të gjithë nëpunësit e pozicioneve të tjera është Drejtori i Drejtorisë, që për nëpunësen F. Hajredinaj, është nëpunësi që mban pozicionin e Drejtori të Drejtorisë së Regjistrimit të Biznesit dhe Lejeve/Licencave/Autorizimeve, ku është e emëruar znj. Elizabeta Furriku.

Në rastin në fjalë, mbështetur në gjetjet e Raportit përfundimtar nr. 5595/1 prot., datë 26.8.2025, *“Raport në përfundim të hetimit administrativ, mbi monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Regjistrimit të Biznesit dhe Lejeve/Licencave/Autorizimeve dhe Sektorit të Regjistrimit të Bizneseve gjatë periudhës janar-korrik 2025”*, të hartuar nga grupi i punës për monitorimin dhe vlerësimin e praktikave administrative, Drejtori i Përgjithshëm ka konstatuar se, nëpunësja F. Hajredinaj ka kryer shkelje me faj, duke i klasifikuar ato si *“mospërmbushje e rëndë e detyrave”*, në kuptim të nenit 57, pika 2, germa a) dhe c), të pikës 2 si dhe në germën a), të pikës 3, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar.

Për këtë arsye, me aktin nr.16731 prot., datë 29.8.2025, *“Nisma për fillimin e procedimit disiplinor ndaj znj. Florina Hajredinaj, Përgjegjëse e Sektorit të Regjistrimit të Biznesit, në Drejtorinë e Regjistrimit të Biznesit dhe Lejeve/Licencave/Autorizimeve”*, drejtuar Komisionit Disiplinor, pranë QKB dhe për dijeni Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse ka nisur procedimin disiplinor në ngarkim të nëpunëses F. Hajredinaj, duke i kaluar çështjen Komisionit të Disiplinës për shqyrtimin dhe vendimmarrje.

Në këto kushte, sa i takon organit të ngarkuar nga ligji për nisjen e ecuresë disiplinore në ngarkim të nëpunësit, në kundërshtim me parashikimet e Udhëzimit nr. 1, datë 21.1.2025,

të DAP, të cituara si më lart, procesi disiplinor në ngarkim të nëpunëses F. Hajredinaj, **nuk ka filluar** nga eprori drejtëpërdrejt i saj, që në këtë rast përkon me nëpunësin e emëruar në pozicionin Drejtor Drejtorie, por, është iniciuar me aktin e Drejtorit të Përgjithshëm, të Qendrës Kombëtare të Biznesit, në tejkalim të kompetencave të tij lëndore. Në këto rrethana, akti nr. 16731 prot., datë 29.8.2025, i nxjerrë nga titullari, për fillimin e ecurisë disiplinore, në kuptim të germës a), pika i) të nenit 108, të ligjit nr.44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, duhet të konsiderohet i pavlefshëm, dhe si i tillë duhet të konstatohet pavlefshmëria absolute në mbështetje të nenit 110 dhe 111, të këtij ligji.

Së dyti, sa i takon evidentimit dhe klasifikimit të shkeljeve në ngarkim të nëpunëses, rezulton se, në konkluzionet e Raportit përfundimtar nr. 5595/1 prot., datë 26.8.2025, të hartuar nga grupi i punës, **nuk janë konstatuar** shkelje të kryera nga Përgjegjësi i Sektorit të Regjistrimit të Biznesit, të cilat mund të shërbenin si indicie për nisjen e procesit disiplinor në ngarkim të kësaj nëpunëseje, nga eprori i drejtëpërdrejtë i saj.

Në këto kushte, shkeljet e konstatuara dhe të klasifikuara nga Drejtori i Përgjithshëm, si “*mospërmbushje e rëndë e detyrave*”, në kuptim të nenit 57, pika 2, germën a) dhe c), të pikës, 2 si dhe në germën a), të pikës 3, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, mbështetur në konkluzionet e arritura nga grupi i punës në përfundim të hetimit administrativ, **nuk qëndrojnë**, e për këtë arsye procesi disiplinor në ngarkim të nëpunëses F. Hajredinaj, është i pambështetur në fakte që provojnë se kjo nëpunëse ka kryer shkelje gjatë kryerjes së detyrës së saj.

Për më tepër, shkeljet e pretenduara nga KD, nuk janë detyrim i Përgjegjësit të Sektorit, që rrjedhin nga përshkrimi i punës, por janë vendimmarrje e nëpunësit të autorizuar (regjistruarit), referuar rregullores së brendshme të institucionit të QKB-së. Pra, në një rast të tillë kur nuk ka lidhje shkak-pasojë, nuk mund të flasim as për elementin faj.

Nga verifikimi i të gjithë dokumentacionit të zhvillimit të kësaj ecurie disiplinore, konstatohet se, në relacionin që Drejtori i Përgjithshëm, ka përgatitur për Komisionin Disiplinor, në të cilin parashtrohen shkeljet e pretenduara që ka kryer nëpunësja dhe vlerësimin e tij për këtë shkelje, nuk ka të bashkëlidhur dokumentacion shkresor që të vërtetojë këto pretendime. Organi disiplinor, në shqyrtimin e këtij rasti, ka marrë të mirëqenë pretendimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe nuk rezulton që të ketë administruar ndonjë dokument shkresor ose ndonjë provë tjetër, të cilat të vërtetojnë shkeljet e kryera apo të flitet për pasojat që ka sjellë ky veprim i nëpunësit.

Në bazë të nenit 82, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i cili përcakton se, “*Në procedurat administrative të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë...*”, rezulton që pala që ka pretenduar për shkeljen disiplinore, nuk e ka përmbushur këtë

detyrim. Nga ana tjetër Komisioni Disiplinor, ka përmbyllur procedimin pa respektuar kërkesat e pikës 14, të Vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil*”, sipas të cilës organi disiplinor vlerëson të gjitha rrethanat e ngjarjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit, si dhe mund të përdorë çdo mjet për të mbledhur prova, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative. Pra, masa disiplinore në këtë rast është marrë pa patur prova dhe pa vlerësuar faktet dhe rrethanat e pretenduara si shkelje disiplinore.

Së treti, në lidhje me pretendimin për përbërjen e Komisionit Disiplinor, rezulton se, ky organ kolegjal është ngritur me Urdhrin nr.121 (nr.16731/1 prot.), datë 29.8.2025, “*Për ngritjen e Komisionit Disiplinor*”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës Kombëtare të Biznesit, me këtë përbërje:

- z. Sokol Bardhi, Drejtori i Përgjithshëm i QKB, në cilësinë e nëpunësit më të lartë civil të institucionit (kryetar i komisionit);
- znj. Elizabeta Furriku, në cilësinë e eprorit direkt (anëtar);
- znj. Doljana Stoja, Përgjegjëse i Njesisë së Burimeve Njerëzore, si përfaqësues i njesisë së burimeve njerëzore (anëtar);
- znj. Viola Treska, si nëpunësi më i vjetër civil i institucionit (anëtar);
- z. Albi Mato, përfaqësues i Departamentit të Administratës Publike.

Ndërkohë, që në vendimin nr. 16731/5 prot., datë 9.9.2025, “*Vendim për fillimin e ecures disiplinore*”, të hartuar nga Komisioni Disiplinor, rezulton se, është përjashtuar eprori drejtëpërdrejtë i nëpunëses, Drejtori i Drejtorisë znj. Elizabeta Furriku dhe nuk është zëvendësuar, me motivacionin se ndaj saj, ka nisur një ecuri disiplinore me shkelje të së njëjtës natyrë, e në këto kushte, Komisioni Disiplinor ka zhvilluar veprimtarinë me 4 anëtar, që janë:

- z. Sokol Bardhi, Drejtori i Përgjithshëm i QKB-së, kryetar;
- znj. Doljana Stoja, anëtar QKB;
- znj. Viola Treska, anëtar QKB;
- z. Albi Mato, anëtar DAP.

Referuar përbërjes së këtij organi kolegjal, rezulton se, është vepruar në kundërshtim me kërkesat e pikës 2, kreu I, të VKM-së nr. 115, datë 5.3.2014, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil*”, i ndryshuar, si dhe pikës 18.1, të Udhëzimit nr. 1, datë 21.01.2025, të DAP, i cili parashikon se, Komisioni i Disiplinës është një organ kolegjal, me 5 anëtar, duke përcaktuar funksionin e secilit anëtar.

Për më tepër, në pikën 22, të Udhëzimit të DAP dhe pikës 6, 7, të kreut I, të VKM-së nr.115, datë 5.3.2014, i ndryshuar, është parashikuar mënyra e zëvendësimit të antarëve të Komisioni, në rast pamundësie të pjesëmarrjes në këtë organ kolegjal.

Në këto kushte, në rast të pamundësisë së pjesëmarrjes së eprorit të drejtëpërdrejtë të nëpunëses, ky anëtar duhej të zëvendësohej sipas pikës 22.1, të udhëzimit nga personi që mban pozicionin e parë të punës në hierarkinë e institucionit pas tij, që korrespondon me titullarin e institucionit.

Ndërsa, sipas pikës 22.2, zëvendësimi i Kryetarit të KD, që në këtë ecuri disiplinore, duhet të merret rolin e eprorit të drejtëpërdrejtë të nëpunëses në procedim disiplinor (*për shkak të përjashtimit të saj*), duhej të bëhej nga eprori i drejtëpërdrejtë, tek i cili ai përgjigjet.

Së katërti, sa i takon anëtarit të KD, znj. Doljana Stoja, e cila ka qenë pjesë e grupit të punës që ka kryer hetimin administrativ për verifikimin dhe vlerësimin e punës së Drejtorisë së Regjistrimit të Biznesit, konstatohet se, në nenin 30, “Pengesat ligjore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se:

“Nëpunësi publik ose anëtar i organit kolegjal nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrës, në rastet kur:

a) ka një interes personal të drejtëpërdrejtë ose jo të drejtëpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim;

ç) nëpunësi publik ose anëtar i organit kolegjal ka marrë pjesë si ekspert, këshilltar, përfaqësues ose avokat privat në çështjen në shqyrtim;

..”

Në rastin konkret, anëtarja e KD-së, znj. Doljana Stoja ka marrë pjesë më parë si anëtare e grupit të punës që ka kryer hetimin administrativ për verifikimin dhe vlerësimin e punës së Drejtorisë së Regjistrimit të Biznesit, QKB për periudhën janar - korrik 2025, gjetjet e së cilit kanë shërbyer si indicie për nisjen e ecurisë disiplinore në ngarkim të nëpunëses F. Hajredinaj. Rezulton e provuar se, anëtarja e KD, ka marrë pjesë më parë si eksperte në vlerësimin e punës së Drejtorisë së Regjistrimit të Biznesit, e për këtë arsye, nuk duhet të ishte anëtare e KD-së, pasi ndodhet në një nga rastet e pengesave ligjore të parashikuara për pjesëmarrjen në këtë procedurë administrative vendimmarrëse.

Së pesti, rezulton e provuar se nuk janë respektuar parimet për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore, nisur nga fakti se, kjo masë është dhënë mbështetur në disa shkelje të cilat, referuar rregullores së brendshme të institucionit **nuk janë detyrë** e Përgjegjësit të Sektorit të Regjistrimit të Biznesit, sikurse u analizua më lart në material.

Gjithashtu, nenit 60, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, parashikohet se, Komisioni Disiplinor, për përcaktimin e masës disiplinore duhet të bazohet në:

- a) shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj;
- b) shkallën e fajësisë;
- c) ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashuara, sipas nenit 61 të këtij ligji.

Ndërsa, në pikën 2, të këtij neni, sanksionohet se: masat disiplinore jepen në raport të drejtë më shkeljen e kryer.

Pavarësisht se, shkeljet disiplinore të pretenduara nga KD, sikurse është konstatuar në Raportin përfundimtar nr. 5595/1 prot., datë 26.8.2025, nuk janë shkelje të kryera nga Përgjegjësi i Sektorit të Regjistrimit, sërisht ky organ në vendimmarrjen e tij, nuk ka marrë në konsideratë asnjë nga elementët e përcaktuar në pikën 1, të në nenit 60 të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, për të marrë një masë në përputhje me shkallën e fajësisë së nëpunëses, pasojave të ardhura, si dhe masave të mëparshme të dhëna në ngarkim të saj, por ka vendosur masën më të rëndë disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”*.

Për më tepër, edhe mendimi i pakicës në Komisionin e Disiplinës, i dhënë nga anëtari përfaqësues i Departamentit të Administratës Publike, ka shprehur qartë dhe haptazi shkeljen e ligjit dhe parimeve bazë të legjislacionit për nëpunësin civil nga Komisioni Disiplinor, i QKB-së, duke kërkuar ndërprerjen e procedimit disiplinor.

Në këto rrethana, rezulton e provuar se, procedura disiplinore e nisur në ngarkim të nëpunëses Florina Hajredinaj, me detyrë *“Përgjegjëse e Sektorit të Regjistrimit të Biznesit”*, në Drejtorinë e Regjistrimit të Biznesit dhe Lejeve/Licencave/Autorizimeve, pranë institucionit të Qendrës Kombëtare të Biznesit, është kryer në kushtet e shkeljes flagrante të dispozitave të akteve ligjore dhe nënligjore që normojnë institutin e disiplinës, në shërbimin civil, ashtu sikurse u arsyetua në këtë vendim. Për këtë arsye, vendimi nr.16731/11 prot., datë 3.10.2025, i Komisionit të Disiplinës për dhënien e masës disiplinore, *“Largim nga shërbimi civil”*, në zbatim të germës a), i) dhe ii), të nenit 108, nenit 110 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative”*, duhet të konstatohet i pavlefshëm nga ana e vetë organit që e ka nxjerrë atë dhe të rregullohen pasojat e ardhura duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit, si dhe urdhrin nr. 144 (16731/12 prot.), datë 03.10.2025, *“Deklarimin e lirimit nga shërbimi civil dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare për nëpunësin civil znj. Florina Hajredinaj”*, të Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës Kombëtare të Biznesit me të cilin është vendosur lirimi nga shërbimi civil për nëpunësen në fjalë.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; të neneve 108, 110 dhe 111 ligjit nr.44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar

me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

Të paralajmëroj institucionin e Qendrës Kombëtare të Biznesit, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke vepruar në këtë mënyrë:

1. Drejtori i Përgjithshëm, i institucionit të Qendrës Kombëtare të Biznesit, në zbatim të nenit 108, 110 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, nëpërmjet një akti të ri me shkrim, duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të cituar si më poshtë:
 - Vendimi nr. 16731/11 prot., datë 3.10.2025, për dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, në ngarkim të nëpunëses Florina Hajredinaj dhe të rregullojë pasojat duke hequr aktin e masës disiplinore nga dosja e personelit të nëpunëses dhe nga Regjistri Qëndror i Personelit.
 - Urdhëri nr. 144 (16731/12 prot.), datë 3.10.2025, “Deklarimin e lirimit nga shërbimi civil dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare për nëpunësin civil znj. Florina Hajredinaj”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës Kombëtare të Biznesit, dhe të rregullojë pasojat e ardhura duke rikthyer nëpunësen në pozicionin e mëparshëm të punës, duke rregulluar edhe efektet financiare të ardhura nga ky akt.
2. Njësia përgjegjëse, pranë institucionit të Qendrës Kombëtare të Biznesit, duhet të ndjekë ecurinë e procesit administrativ, për realizimin e veprimeve të mësipërme.
3. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat **10** ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Qendrës Kombëtare të Biznesit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Departamenti i Administratës Publike, si dhe nëpunësja Florina Hajredinaj.
6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil,

nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha